

Projekt-Skema e videokasetes

“POLICIA DHE
TE DREJTAT E
NJERIUT”

Përgatiti: *Arqile Kosta*

Titulli: Respektojmë dhe mbrojmë të drejtat e njeriut

1. Titrat e publikimit dhe logot e Ministrisë dhe Qendrave Shqiptare dhe Daneze për të Drejtat e Njeriut (*Mbahet për disa sekonda*)
2. Qëllimi (*Të ndihmojë gjatë trainimeve të policise në të drejtat e njeriut – Mbahet 10 sekonda*)
3. Intervista: (*çdo intervistë jo më tepër se 1 minutë sejcila*)
 - a. Me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit
 - b. Me znj. Kozara Kati (QSHDNJ)

4. Titra: Te drejtat themelore të njeriut

Kushtetuta e Shqipërisë

- Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik (Neni 15)
- Kufizime të drejtave dhe lirive themelore të njeriut mund të vendosen me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përputhje me gjendjen që e ka diktuar atë. (Neni 17)
- Të gjithë janë të barabartë para ligjit (Neni 18)
- Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkak të tillat si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore sociale ose perkatesia prinderore (Neni 18)
- Jeta e personit mbrohet me ligj (Neni 21)
- E drejta e informimit është e garantuar (Neni 23)
- Askush nuk mund të nënshtrohet torturës, denimit ose trajtimit mizor, çnjerezor ose poshterues. (Neni 25)
- Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (Neni 27)
- Kushdo quhet i pafajshëm derisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. (Neni 30)
- Paprekshmeria e banesës është e garantuar. (Neni 37)
- Liria e tubimeve paqësore dhe pa arme, si dhe pjesëmarrja në to është e garantuar (Neni 47)

Skena 1

Një kembësor në një lagje qyteti vren dy djem të rinj që hyjnë nga muri në një shtëpi banimi. Dyshon dhe duke shkuar në telefonin publik me të afert merr numurin 19 të qendres të Patrullave Shqiptonja duke e informuar për dyshimin. Dispeçeria njofton në radio patrullat me të aferta. Patrulla e parë mbrin në vend ngjarje dhe duke u afruar me kujdes hyn në shtëpi. Dy keqberesit janë duke kerkuar nëpër shtëpi për sende me vlerë. Polici i parë i patrullës në rolin e vepruesit ben thirrje për t'u dorzuar sapo shikon keberesit. Njeri keqberes largohet me vrap nga dritarja e hapur. Polici e ndjek pas. Polici i dytë i afrohet keqberesit të dytë për ta prangosur. Befas keqberesi e sulmon me duar dhe e ve poshte.

Nderkohe kanë mbritur policet e patrullës së dytë dhe hidhen në ndihme të kolegut të tyre të rezuar. Mbasi e vënë poshtë keqberesin duke i përdredhur duart mbas kurrizit, njeri e qellon me kembe në ije. Polici i sulmuar terheq vemendjen për panevojshmerinë e përdorimit të forcës pasi sulmuesi është i bllokuar dhe i parrezikshëm (*dialog midis policit të sulmuar dhe atij që goditi me kembe – ky qen*

keshtu e do pasi ka goditur policin – Detyra jone eshte ta kapim keqberesin dhe jo ta ndeshkojme e ta fyejme. Nuk duhet teperuar me forcen. Permendet standarti per te perdorur force te pershkallezuar, per t’u denuar nga nje gjyq dhe te drejtat e personit qe akuzohet per nje krim etj)

Polici i dyte nuk ka mundur ta arrije keqberesin e dyte i cili eshte larguar tashme ne drejtim te paditur (mbahen shenim karakteristikat e te larguarit dhe verifikohen duke pyetur te arrestuarin ne flagrante i cili nuk bashkepunon. E futin ne makinën e policise dhe largohen per ne komisariat

Skenari

Planet e pamjeve

Dialog:.....

Titra: Si të arrestojmë dhe të shoqërojmë dikë që ka kryer një krim në flagrancë?

Standartet e perdorimit te forces dhe te shoqerimit (me urdher ndalimi ose jo)

Titra: Përdorimi i forcës

- Perdoret vetem minimumi i forces
- Perdoret proporcionalisht
- Vetem per tu vetmbrojtur ose mbrojtur koleget ose qytetaret e kercenuar
- Te jete e mjeftueshme sa per t’e kryer prangosjen
- Per te zbatuar ligjin

Skena 2

Ne komisariat, tek oficeri i informacionit behen veprimet e evidentimit. Nje inspektor krimesh polic qe e njeh keqberesin i irrituar se ai ka vjedhur serish e qellon me shuplake, polici i dhomave te izolimit, qe e ka marre ne dorzim e pengon dhe i kujton rregullat e trajtimit te te ndaluarit dhe e paralajmeron se do ta raportoje per sjelljen jo etike dhe joligjore te tij (*standarti i moscenimit te dinjitetit dhe i mostorturimit*). Drejtuesi qe ndodhet prezent terheq vemendjen per respektimin e standarteve kushtetuese dhe te ligjit.

I ndaluari futet ne dhomen e posacme per trajtimin ligjor ne raste te tilla

Skenari

Planet e pamjeve

Dialog

Titra: Ç'është shoqërimi, arrestimi dhe ndalimi

(Përsëriten standaretet kushetuese neni 37, 21, 23, 25, 27 dhe 30)

(Ligji për Policinë e Shtetit, neni 27, 39, 40, 43, 45, 46)

Kodi i procedurës penale nenet ...

Skena 3: Gurmimi dhe kërkimi i personit

Dy inspektore ose agjente të policisë kriminale hyjnë në zyrën e shefit dhe pasi ulen në tavolinë, ky i fundit ju ve përpara një dosje duke ju thënë se duhet të e identifikojnë dhe të arrestojnë një të kërkuar për të cilin ka dyshime se fshihet në një shtëpi, Policet shohin dosjen, bëjnë pyetje për sqarime të mëtejshme dhe dalin.

Dy policet duke diskutuar i afrohen shtëpise që duhet të kontrollojnë dhe trokasin në derë. I zoti i shtëpise, një djale i ri e hap dhe me mirësjellje i pyet ç'dëshironin dhe me se mund t'i ndihmonte. Polici i parë i tregon dokumentin që autorizon kontrollin e banesës dhe pas kësaj se bashku hyjnë në shtëpi.

Brenda dy policet fillojnë të kontrollojnë neper dhoma dhe vende ku mund të fshihet personi. Njeri nga policet në dhomën e gjumit fillon të kontrollojë neper sirtare dhe në kutitë e bizhuterive. Polici i dytë i terheq vëmendjen se kontrolli i tij ishte i paligjshëm dhe i panevojshëm pasi personi nuk mund të fshihej në të.

Dalin në oborin e shtëpise dhe i afrohen bodrumit apo garazhit apo depos. Sapo hapin derën, një person del dhe largohet me vrap. Polici i parë është shumë i kujdesshëm dhe duke ju vënë mbrapa, e kap menjehere dhe mbasi e kontrollojë e prangos (*zbatohen procedurat standarte të kontrollit fizik të personit*). Afrohet edhe polici i dytë dhe i thënë shkakun pse po arrestohet.

Në komisariat të dy serish tek shefi i tyre duke i raportuar për ndalimin.

Skenari

Planet e pamjeve

Dialog: ...

Titra: Standardet për kërkimin e personit, kontrollin e banesave private dhe gjurmimi.

Kushtetuta

Ligji i procedurës penale

Shkaqet e arsyeshme

Kërkimi me urdher arresti nga policia (ç' duhet të ketë një urdher kërkimi, rastet kur aplikohet – urdheri, gjurmet, informacionet, identikiti)

Kujdesi për të drejtat e njeriut

Kthim tek kushtetuta - rrespektimi i të drejtave që lidhen me hyrjen në banesë, kontrollin fizik, përdorimin e forcës dhe shoqërimin)

Rregullat e marrjes në pyetje

Skena 4: Në postblokun policisë

Një postblok i zakonshëm në një kryqezim rrugë në periferi të qytetit. Dy policet e postblokut i japin shenjën e ndalimit një makine të vogël. Drejtuesi i mjetit, një djalosh 17-20 vjeçar, del nga mjete i qete, i drejtohet me blokun e dokumentave në dorë policit që bërë shenjën dhe kur i vjen fare pranë, nxjerr një aerosol lotsjelles, qellon policin me një curril në fytyrë dhe largohet me vrap. Polici i dytë pasi sigurohet që kolegu nuk ka gje, ndjek me vrap dhe qellon me pistoletë djaloshin që nderkohe është duke kaluar një mur të ulët. Polici i parë lajmeron në radio për komplikimin e situatës dhe shkon pas kolegut. Polici i dytë, në ndjekje del në një rrugë kryesore me një rrez dhe qellon serish me armë duke plagosur një kalimtar. Nderkohe arrijnë edhe dy grupe të tjera policësh dhe së bashku vijojnë ndjekjen derisa arrijnë në një oborr të një fabrike të braktisur. I ndjekuri duke vënë re që nuk ka ku të shkojë ndalon dhe i mbështetur mbas murit ngre duart për t'u dorzuar. Policet i hidhen sipër dhe, pasi e shtrijne për toke, fillojnë ta godasin me grushta, shkelma dhe shkopinjte e gomes

Skenari

Planet e pamjeve

Dialog:

Titra 1: Cilat janë gabimet? (shfaqen pyetje me slida nga 3 sekonda)

- Në procedurat e kontrollit fizik në postblokun e policisë?
- Në përdorimin e armëve të zjarrit?
- Në përdorimin e forcës fizike?

- Në arrestimin e personit?
- Në teknikat e mbijetesës të punonjesit të policisë?

Evidentoni standartet kushtetuese dhe ligjore?

- Kontrolli i personit
- Përdorimi i armëve të zjarrit dhe forcës
- Arrestimet dhe ndalimet

Titra 2:Kujtesë mbi postblokun dhe kontrollet

(Titra nga Urdhëri për postbloqet dhe kontrollet)

Titra 3: Brutaliteti

Pjesë standartesh, ligjesh dhe rregullash që ndalojnë brutalitetin si një sjellje joprofesionale dhe antiligjore

- Nga Konventa për ndalimin e torturës dhe trajtimeve çnjerzore
- Nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Nga kodi i etikës
- Nga rregullorja e disiplinës

Video shtojcë

(kjo pjesë përfshihet e veçuar, si aneks, për ta përdorur si material ilustrativ gjatë diskutimeve në seancat e trainimit)

Montazh me pjesë reale filmike nga mediat televizive, që tregojnë raste të keqsjelljes dhe brutalitetit nga policët

1. Pjesët nga videokaseta e lajmeve të BBC
2. Rasti i Afrikës së Jugut me qenin e policisë e shfaqur nga kanali televiziv CNN në 2000
3. Pjesë nga trazirat dhe rastet e evidentuara nga mediat televizive të ndodhura në Shqipëri (përfshihen pa komentet e bëra nga gazetari që i ka filmuar)